

## ABSTRAKT

- I. Çështja e luftës fillimisht ishte rregulluar me të drejtën zakonore, kurse zhvillimi i marrëdhënieve politike dhe ekonomike në botë, zhvillimi i shpejtë i teknikës luftarake dhe shumë faktorë të tjerë, kanë ndikuar në formimin e rregullave të cilat kanë të bëjnë me luftën dhe çështjet në lidhje me luftën. E drejta ndërkombëtare humanitare është krijuar për të mbrojtur njerëzit nga fatkeqësitë e luftës dhe është zhvilluar në kuadër të së drejtës ndërkombëtare.
- II. Pjesa më e madhe e të drejtës ndërkombëtare humanitare është e përfshirë në katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949. Për shkak të pësimeve të mëdha të civilëve, sidomos pas Luftës së II Botërore, është shtruar nevoja e nxjerrjes së rregullave të reja që të mbrohej efektivisht popullsia civile gjatë konflikteve të armatosura. Kjo është arritur me miratimin e Konventave të Gjenevës së 12 gusht 1949 dhe protokollove shtesë.
- III. Rol të rëndësishëm në luftën në Kosovë dhe në konfliktet e viteve të 90-ta ka pasur GJPNJ, e cila ndryshoi në mënyrë të pakthyeshme peizazhin e së drejtës ndërkombëtare humanitare, u dha viktimave një mundësi për të shprehur tmerret që panë dhe përjetuan, dhe dëshmoi se për ata që dyshoheshin se mbanin përgjegjësinë më të madhe për mizoritë e kryera gjatë konflikteve të armatosura mund të kërkohej llogari.
- IV. Gjatë viteve 1998-2000, gjatë luftës në Kosovë, 13.548 persona kanë rënë, janë vrarë dhe zhdukur, prej të cilëve, për fatin e 1.620 personave ende nuk dihet asgjë, kurse mendohet se rreth 20.000 persona mund të jenë të dhunuar. Nga rastet e paraqitura në QKRMT, si viktima të dhunës seksuale janë 844 femra dhe 56 meshkuj. Në rastet kur të pandehurit janë të pa arritshëm për organet e rendit dhe procedura ndaj tyre nuk ka mundur të fillohet, tashmë sipas nenit 346/A, të Ligjit nr. 06/1 -091, është mundësuar gjykimi në mungesë për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të drejtës ndërkombëtare penale, të kryera në periudhën prej muajit janar të vitit 1990 deri në muajin qershor të vitit 1999. Me këtë rast, aktakuzat e para janë ngritur dhe gjykimi për një rast ka filluar.
- V. Të pandehurit për krime lufte në Kosovë, janë hetuar dhe gjykuar pranë TPNJ-së, gjykatave në Serbi, gjykatave në Mal të Zi, gjykatave themelore në Kosovë - tashmë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special si dhe pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. Këtu, kam trajtuar disa raste, të cilat tashmë kanë vendim të formës së prerë.

Kandidati:

Dren KAÇANDOLLI